



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E JUNIKUT  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

“Univerzum-Audit” Sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore te Komunës se Junikut për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga “Univerzum Audit” Sh.p.k nga Armend Osaj udhëheqës i ekipit si dhe anëtarëve Taulant Murati dhe Elvirë Pllana.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Qeverisja e mirë .....	21
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	29
Shtojca II: Letër Konfirmimi.....	32

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Junikut për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 19/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Junikut.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


#### **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pronat komunale edhe pse janë identifikuar dhe vlerësuar, ato ende nuk janë regjistruar në modulin e pasurisë në SIMFK, ndërsa për pasurinë jokapitale nuk ka regjistër të plotë dhe të saktë.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase;
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Junikut, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante i'u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshtetur më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- 275 prona komunale janë identifikuar dhe vlerësuar, mirëpo ende nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së;
- Programi e-pasuria është përdorur më shumë gjatë vitit 2018, mirëpo ende jo mjaftueshëm për shkak se regjistrimet nuk janë bërë edhe për periudha paraprake. Si rezultat nuk ekziston një regjistër i plotë dhe i saktë për pasurinë jokapitale dhe materialin shpenzues.

---

Kjo reflekton pasaktësi dhe jo plotësi në regjistrin e pasurisë dhe shpалosje të pasaktë në PVF-të e vitit 2018.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Kryetari i Komunës së Junikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës së Junikut është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna e Junikut kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Pyetësorin e vet-vlerësimit të komponenteve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike dhe
- Harmonizimet tremujore të shpenzimeve dhe të hyrave me Thesar.

PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Në PVF-të e Komunës së Junikut, edhe më tutje shpalosjet për pasurinë kapitale, pasurinë jokapitale dhe materialit shpenzues nuk janë të sakta (ref.Theksimi i çështjes te opinioni i auditimit).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave të tjera për raportim të jashtëm Komuna ka dërguar në Ministrinë e Financave raporte të detajuara tremujore për progresin fizik në zbatimin e projekteve kapitale.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e përmendura më sipër jepen rekomandimet:

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e saktë të pasurisë. Duhet të vazhdohet në zbatimin e rekomandimeve të bëra gjatë auditimeve paraprake sipas planit të veprimit si dhe nevojitet përmirësim në përpilimin e planit vjetor të prokurimit, gjegjësisht planifikimi më i mirë i prokurimit është i nevojshëm. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse Komuna e Junikut ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbetin disa fusha ku nevojiten zhvillime të mëtutjeshme. Disa nga çështjet e ngritura nga auditimi i vitit të kaluar nuk janë përfunduar në tërësi. Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë është bërë mirëpo nuk është regjistruar në SIMKF, si rrjedhojë konsiderohet se nuk është trajtuar sa duhet nga menaxhmenti.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm për të parandaluar mangësitë e identifikuar. Përmirësimet kërkojnë kryesisht në planifikimet e blerjeve përmes prokurimit publik, në zotimin e mjeteve si dhe në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,730,462</b>	<b>2,152,048</b>	<b>2,082,278</b>	<b>1,754,304</b>	<b>1,584,964</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,631,453	1,982,604	1,974,583	1,534,867	1,179,419
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	-	38,529	17,407	17,697	13,442
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	99,009	99,009	60,851	89,483	69,306
Donacionet e brendshme	-	17	-	20,900	4,082
Donacionet e jashtme	-	31,889	29,437	91,357	318,715

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 421,586€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së Grantit të Qeverisë në vlerë prej 351,151€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 38,529€, doancioneve të brendshme në vlerë prej 17€ si dhe donacioneve të jashtme në vlerë prej 31,889€.

Në vitin 2018, Komuna e Junikut ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 2,082,278€, me një përmirësim prej 84% krahasuar me vitin 2017. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,730,462</b>	<b>2,152,048</b>	<b>2,082,278</b>	<b>1,754,304</b>	<b>1,584,965</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,118,322	1,085,806	1,085,806	1,054,758	1,005,752
Mallrat dhe Shërbimet	149,956	179,974	177,073	184,416	211,927
Shërbimet komunale	30,000	38,000	33,005	29,476	29,904
Subvencionet dhe Transferet	5,755	15,755	15,600	6,050	5,460
Investimet Kapitale	426,429	832,513	770,794	479,604	331,922

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshijnë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Paga dhe mëditje – buxheti final është zvogëluar për 32,516€. Zvogëlimi është ndikuar nga transferi i Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas vendimit të Qeverisë nr. 07/80 të datës 18.12.2018, të transferuara te niveli qendror nga kategoria e pagave.
- Mallra dhe shërbime – buxheti final është rritur për 30,018€. Fillimisht kjo rritje është ndikuar nga donacionet e KOSTT në vlerë prej 17.50€, nga transferi i Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas vendimit të Qeverisë nr. 04/74 te datës 06.11.2018 në shumë 30,000€.
- Shërbimet Komunale – janë rritur për 8,000€. Kjo rritje është ndikuar nga transferi i Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas vendimit të Qeverisë nr. 04/74 të datës 06.11.2018 në shumë prej 8,000€.
- Subvencionet dhe Transferet – buxheti final është rritur për 10,000€. Kjo rritje është ndikuar nga transferi i Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas vendimit të Qeverisë nr. 04/74 te datës 06.11.2018 në shumë prej 10,000€.
- Investimet Kapitale – buxheti final është rritur për 406,085€. Kjo rritje është ndikuar nga transferi i donacioneve në shumë prej 260,98€ nga UN-HABITAT, nga Helvetas Swiss Intercooperation (DEMOS) në shumë prej 25,628€, nga Save the Children në shumë prej 6,000€, transferi i të hyrave të pashpenzuara të vitit 2017 të bartura për shpenzim në vitin 2018 në shumë prej 38,529€, nga transferi i Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas vendimit të Qeverisë nr. 04/74 të datës 06.11.2018 në shumë prej 250,000€, si dhe nga transferi nga

Qeveria e Republikës së Kosovës sipas vendimit të Qeverisë nr. 11/79 të datës 11.12.2018 në shumë 85,667€.

## Rekomandim

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Junikut ishin 119,108€ apo 120% e planit. Në raport me vitin paraprak, niveli i realizimit të të hyrave është zvogëluar për 2.5%. Në të hyrat e realizuara dominojnë të hyrat tatimore me 64,776€ dhe të hyrat jo tatimore 54,332€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	99,009	99,009	119,108	122,377	83,989

#### Çështja B2<sup>4</sup> – Mangësi në regjistrim të të hyrave

**Gjetja** Në disa raste kemi vërejtur që të hyrat janë regjistruar deri në një javë me vonesë, për shkak të pamundësisë së regjistrimit mbrapa në sistem.

**Rreziku** Regjistrimi me vonesë i të hyrave e vështirëson harmonizimin e të dhënave dhe raportimin financiar, përveç asaj raporti tre mujor nuk do të paraqesë gjendjen reale të komunës në atë datë.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurohet se të hyrat regjistrohen me kohë në SIMFK në mënyrë që analizat dhe raportimet të mbështeten në informata të sakta.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Në fund të vitit 2018, Komuna e Junikut kishte 163 të punësuar, përfshirë edhe 39 anëtarët e Kuvendit Komunal. Për paga dhe mëditje është shpenzuar i tërë buxheti i kësaj kategorie apo 1,085,806€. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në shpenzimet totale të komunës është 52%.

<sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

---

## Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.3 Menaxhimi i personelit

Auditimi jonë ka përfshirë dosjet e personelit, procedurat e rekrutimit, vlerësimet vjetore të performancës, pensionimet si dhe pushimet pa pagesë dhe të lehonisë. Personeli administrativ me status të shërbyesve civil menaxhohet nga zyra e personelit në Komunë, ndërsa personeli edukativo-arsimor dhe personeli shëndetësor menaxhohen nga drejtoritë përkatëse, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

---

#### Çështja B3- Parregullsi në menaxhimin e personelit

**Gjetja** Për pozitën në drejtorinë e shëndetësisë ndonëse ishte kërkuar me konkurs, kandidati nuk kishte ofruar me kohë vërtetimin nga gjykata që dëshmon se aplikuesi/ja nuk është në procedurë të hetimeve apo i dënuar me vepër penale në kohën e aplikimit, të njëjtën mungesë dokumentacioni e kemi vërejtur edhe tek një pjesë e stafit të angazhuar me kontratë mbi vepër.

**Rreziku** Shmangia dhe mos zbatimi i duhur i kërkesave dhe procedurave të rekrutimit, përveç që është në kundërshtim me rregullat dhe procedurat ligjore, rritë rrezikun të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur si dhe nuk siguron nëse është punësuar personel adekuat.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet e rekrutimit zhvillohen në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante të cilat sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.

### 3.1.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra e shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2018 ishte 217,973€. Prej tyre ishin shpenzuar 209,697€ apo 96% e buxhetit të këtyre dy kategorive. Kryesisht ato kanë të bëjnë me shpenzimet e shërbimeve komunale dhe me aktivitetet operative që ndërlidhen me shërbime të tjera kontraktuese, furnizim për zyre dhe pajisje, derivate, mirëmbajte etj.

---

**Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e marrëveshjeve për shërbime të veçanta**

- Gjetja** Përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta ishin angazhuar pesë punonjës. Njëri nga ta është angazhuar në zyrën e Kryetarit si Këshilltar Politik, kontrata e të cilit fillon prej Janar 2018 deri në përfundim të mandatit të Kryetarit. Për angazhimin e tij nuk është zhvilluar ndonjë procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Njëri punonjës është angazhuar në Administratë si dhe tre të tjerët në Shërbime publike prej të cilëve vetëm dy punonjësve të angazhuar në shërbime publike u janë ndjekur procedurat e rekrutimit.
- Rreziku** Anashkalimi i procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit me rastin e lidhjes së kontratave për shërbime të veçanta, rritë rrezikun të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur për kryerjen e shërbimeve të kërkuara.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit dhe vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike si dhe ato të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.

---

### 3.1.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për Subvencione dhe transfere në vitin 2018 ishte 15,755€. Prej tyre ishin shpenzuar 15,600€ apo 99% e buxhetit të këtyre dy kategorive. Subvencionet janë dhënë për përfitues individual, entitete publike si dhe jo publike. Gjatë periudhës Janar-Tetor janë ndarë gjithsej 5,700€ për subvencione ndërsa për periudhën Nëntor- Dhjetor janë ndarë gjithsej 9,900€.

---

#### Çështja C1 - Mungesa e rregullore për subvencione

**Gjetja** Komuna e Junikut nuk ka pasur rregullore të aprovuar për ndarjen e subvencioneve deri më 31 Tetor të vitit 2018. Ndarja e tyre është bërë vetëm në bazë të kërkesave të cilat janë aprovuar nga ana e Kryetarit të Komunës.

Për subvencionet e ndara gjatë periudhës Nëntor- Dhjetor rregullorja ka qenë e aprovuar mirëpo gjatë procesit të auditimit kemi parë që nuk janë përfillur të gjitha kërkesat për aplikim për subvencion si dhe nuk janë kompletuar dosjet e aplikantëve.

**Rreziku** Mungesa e zbatimit të rregullore krijon paqartësi rreth projekteve të subvencionuara dhe nëse ndarja e subvencioneve është në përputhje me planet dhe objektivat e përcaktuara.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë se rregullorja për subvencion zbatohet duke percjellë të gjitha procedurat përkatëse, deri te miratimi i tyre. Për më shumë Kryetari duhet të sigurohet që percjellen procedurat edhe për monitorim dhe raportim sipas rregullore në fuqi.

### 3.1.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 832,514€ ndërsa janë shpenzuar 770,794 ose 93% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me financimin e projekteve kapitale në infrastrukturën rrugore, objektet arsimore dhe mirëmbajtjen investive, hartimin e projekteve, etj.



---

## Çështja A1 - Ndërrimi i menaxherit të projektit nga punëkryesi pa aprovim paraprak të komunës

### Gjetja

Operatori ekonomik fitues në projektin “Asfaltimi i rrugëve lokale në lagjen e Gaxherëve”, për të plotësuar kërkesën për pikën III.2.4. - Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkesa me numër 2 në lidhje me stafin profesional të kërkuar, ka ofruar nja kontratë të bërë me një kompani tjetër, ku thuhet se operatorit ekonomik i cili mëpastaj shpallet fitues i ipet në shfrytëzim stafi për të konkuruar në tender të ndryshëm në tërë territorin e Kosovës dhe jo në shfrytëzim për realizimin e projektit në fjalë. Fillimisht kjo dëshmi e ofruar është konsideruar si e papërgjegjshme nga ekipi vlerësues, mirëpo pas shqyrtimit të lëndës në OSHP, ajo është kthyer në rivlerësim dhe pastaj gjatë procesit të rivlerësimit kjo dëshmi është konsideruar si e përgjegjshme. Njëra prej kërkesve në dosje në një pjesë e kapaciteteve teknike dhe profesionale ishte që menaxheri i projektit të ketë së paku tri vite përvojë pune, diplomat të jenë të noterizuara, të ofrojë kontratën për marrëdhënie pune dhe referenca pozitive për punët e kryera deri më tani, kërkesa të cilat operatori ekonomik i ka plotësuar duke ofruar stafin e huazuar.

Mirëpo, gjatë realizimit të projektit si menaxher i projektit ka qenë një person tjetër. Ne nuk kemi mundur të sigurojmë ndonjë dëshmi që komuna është njoftuar me kohë për zëvendësimin e menaxherit të projektit. Për më shumë, nuk kemi pasur informata se personi i cili ka udhëhequr projektin ka pasur përvojë dhe kualifikime ashtu siç janë kërkuar fillimisht me kontratë.

Përveç kësaj i njeiti operator ka konkurruar dhe i ka fituar edhe dy projekte të tjera të komunës, pak a shumë në të njejtën kohë, duke i plotësuar kriteret e përzgjedhjes me personel të njetë, të huazuar dhe duke mos angazhuar pastaj personelin e ofruar në realizimin e punimeve.

### Rreziku

Mos respektimi i kriterëve profesionale paraqet rrezik të vazhdueshëm që punët në projekt nga operatori ekonomik të mos kryhen ashtu siç janë paraparë dhe kërkuar nga Komuna.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë që personat profesional të ofruar nga operatori gjatë procesit të ofertimit duhet të jenë të angazhuar për punë për të cilën edhe janë kërkuar nga komuna. Mbikqyrësi i caktuar nga komuna duhet të sigurojë që personat e tillë janë angazhuar në realizimin e projektit. Në rastin kur operatori ekonomik duhet zëvendësuar këta persona, atëherë paraprakisht ata duhet të jenë të aprovuar nga komuna, në mënyrë që të sigurohet që operatori ekonomik ka profesionalizëm të duhur në realizimin e projektit.



---

## Çështja C2 - Ndarje jo e drejtë e detyrave dhe përgjegjësi

- Gjetja** Në se paku dy raste komuna nuk ka respektuar kërkesat e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit (neni 62.3) lidhur me ndarjen e duhur të detyrave gjatë procesit të prokurimit. Zyrtaret e njëjtë të cilët kishin përgatitur specifikacionin teknik janë angazhuar si menaxher të po atyre kontratave.
- Ne projektin “Ndertimi i rrjeti sekondar te kanalizimit”, fillimisht menaxher i kontratës është caktuar zyrtari i cili ishte përfshirë si anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave per kete projekt. Pas kërkesës zyrtare për lirim nga kjo detyre, menaxher i kontratës caktohet një zyrtari tjetër, i cili po ashtu ishte anëtar i komisionit të vlerësimit të tenderit. Poashtu edhe te “Mirembajtja e rrugeve lokale”, anetari i komisionit per vleresim te ofertave njekohesisht eshte caktuar menaxher i mbikeqyrjes se projektit. Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik, përcakton se anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohen si menaxher të projektit.
- Rreziku** Mangësitë në menaxhimin e kontratave zvogëlojnë sigurinë që punët/shërbimet realizohen në harmoni me kushtet/specifikat e parapara në kontratë dhe ndarja jo e duhur e detyrave mund të shkaktojë konflikt interesi në menaxhimin e proceseve.
- Rekomandimi C2** Kryetari duhet të sigurojë se kontrollat janë efektive në zbatimin e proceduarve të prokurimit dhe menaxhimin e kontratave si dhe të aplikoj masa për ndarje të duhur të detyrave në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore.

---

## Çështja C3- Mangësi në proces të vlerësimit të ofertave dhe të pranimit teknik të projekteve

**Gjetja** Në sërë paku katër raste të investimeve kapitale janë konstatuar mangësi apo lëshime në procesin e vlerësimit të ofertave apo në procesin e pranimit teknik të projekteve. Njëri lëshim lidhet me pranimin teknik në projektin e “Ndërtimit sekondar të kanalizimit” ku edhe pse projekti ka përfunduar, komuna ende nuk ka përfunduar pranimin teknik. Mangësi e njëjtë është vërejtur edhe te projekti “Asfaltimi i rrugëve lokale faza e II-të”. Për më shumë në këtë projekt punëtorët profesional të paraqitur nga operatori ekonomik, i cili ishte pjesë e konzorciumit fitues, nuk janë punëtor të deklaruar në regjister të ATK-së, gjegjësisht kontratat e punës të paraqitura në dosje të tenderit, janë kontrata të nënshkrua me një entitet tjetër i cili është në Shqipëri. Lëshimi i katërt ka të bëjë me “Mirëmbajtjen e rrugëve lokale” ku operatori fitues ka prezentuar punëtor të kualifikuar me kontratë pune valide, mirëpo të cilët nuk figurojnë në listat e puntorëve të prezentuar dhe deklaruar në ATK.

**Rreziku** Mos respektimi dhe shpallja e operatorit fitues pa plotësimin e kërkesave preliminare apo ato profesionale, rrezikon që të bëhet përzgjedhja e operatorit i cili mund ta rrezikoj vetë realizimin e projektit për të cilin është përzgjedhur.

Përveç kësaj konsiderimi i projektit si i përfunduar pa përfundimin e pranimit teknik paraqet rrezik që projekti të mos jetë i përfunduar ashtu siç është paraparë, e në anën tjetër të jetë i paguar.

**Rekomandimi C3** Kryetari duhet të sigurohet që komisioni i vlerësimit duhet të bëjë vlerësimin e ofertave saktësisht sipas kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit.

Kryetari poashtu duhet të sigurohet që secili projekt i përfunduar ka të kryer pranimin teknik.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PVF-ve, vlera neto e pasurisë kapitale në fund të vitit është 2,796,000€, ndërsa e pasurisë jokapitale 124,153€. Komuna e Junikut ka krijuar komision punues dhe ka bërë inventarizimin apo numërimin fizik të pasurisë në fund të vitit 2018. Një komision tjetër punues për vlerësimin e pasurisë gjithashtu ishte krijuar dhe ka bërë evidentimin e pronave komunale dhe vlerësimin e tyre. Mirëpo pronat komunale të evidentara dhe vlerësuara ende nuk janë evidentuar në regjistrin kontabël të pasurive, çështje kjo të cilën e kemi trajtuar tek Kapitulli i Opinionit të Auditimit – Theksimi i çështjes. Përveç kësaj, janë hasur edhe mangësi tjera të prezantuara në vijim.

---

## Çështja A2 - Mangësi në regjistrim të pasurive në vijim

**Gjetja** Situacionet e projekteve të realizuara nuk regjistrohen si investime në vijim por drejtëpërdrejtë si pasuri kapitale.

Si rezultat, një projekt në SMKf figuron në disa pozicione varësisht se sa situacione ka gjatë realizimit të tij. Për më shumë, regjistrimi i tillë jo vetëm që ndikon në prezentim jo të drejtë të pasurive në pasqyra financiare pasi që nuk prezentohet fare vlera e investimeve në vijim, por edhe ndikon në zhvlerësim jo të drejtë të pasurive kapitale. Ato fillojnë të zhvlerësohen nga momenti kur situacioni regjistrohet në SMKf, e jo nga momenti kur projekti përfundohet në tërësi.

**Rreziku** Mos regjistrimi i investimeve në vijim ndikon në mos prezentim të drejtë të pasqyrave financiare si dhe në zhvlerësim jo të drejtë të pasurive komunale.

**Rekomandimi A2** Komuna, situacionet e realizuara duhet ti regjistroj në SMKf si investime në vijim. Pastaj me përfundim të projektit, duhet të bëhet kërkesa në thesar që situacionet e regjistruara të hiqen dhe pastaj të kapitalizohet i tërë projekti si i përfunduar në SMKf.

## Çështja A3 - Vlera e pasurive nën 1,000 € e gjeneruar nga E-pasuria

**Gjetja** Në PFV të vitit 2018 vlera e pasurive nën 1,000€ figuron 124,153€. Me rastin e verifikimit të këtyre pasurive në e-pasuri është vërejtur se në këtë saldo 75,216€ kanë të bëjnë me materiale shpenzuese që janë regjistruar gjatë vitit e të cilat nuk janë shkarkuar nga e-pasuria. Si rrjedhojë vlera e pasurive nën 1,000€ duhet të ishte 48,937€. Për më shumë kjo vlerë mund edhe të pësojë ndryshime, pasi që lista e pasurive në e-pasuri nuk është e plotë për shkak të jo-saktësisë së regjistrimeve në vitet paraprake.

**Rreziku** Mos ekzistimi i listës së plotë të pasurive nën 1,000€ në e-pasuri, shkakton mos prezentim të drejtë të këtyre pasurive në PFV të komunës, si dhe ndikon negativisht në menaxhimin e ruajtjen e këtyre pasurive nga ana e komunës.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurohet që lista e gjeneruar nga e-pasuria është e plotë dhe prezenton saktësisht vlerën e pasurive nën 1,000€ të cilën komuna e ka në pronësi. Poashtu kryetari duhet të sigurohet që personi përgjegjës për menaxhim të pasurive ka nivelin e duhur të njohurive dhe raporton saktësisht vlerën e pasurive në PFV.

---

### 3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta, janë fond i vogël i parave që mbahen në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisë më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

### 3.4 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme (LI/A) kanë të bëjnë me tatimin në pronë dhe të hyrat nga taksat në biznes. Gjatë vitit 2018 janë vërejtur arkëtime më të mëdha dhe përmirësim sidomos të arkëtimit të tatimit në pronë dhe taksave në afarizëm, mirëpo për shkak të rritjes së të hyrave nga këto dy burime, të vlera e përgjithshme e të arkëtueshmeve nuk vërehet ndonjë ndryshim nga viti 2017. Si rrjedhojë konstatohet se ka përmirësime në menaxhim të llogarive të arkëtueshme, por nevojitet që të vazhdohet me veprime në mënyrë që arkëtimi i tyre edhe me tutuje të përmirësohet. Siç edhe është prezantuar në PVF, vlera e përgjithshme e tyre arrinë në 190,000€, ku 76% e tyre i takon tatimit në pronë, ndërsa 23.5% i takon taksave në afarizëm.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Obligimet e papaguara

Sipas PFV-ve, obligimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishin 10,496€, ku prej tyre 4,978€ i takojnë investimeve kapitale, 4,693€ mallrave dhe shërbimeve dhe 1,825€ shërbimeve komunale. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Përveç detyrimeve financiare, Komuna e Junikut përballet edhe me detyrime kontingjente dhe vlera e tyre pritet të jetë rreth 43,000€.

---

## Çështja B5 - Hyrje në obligime pa mjete buxhetore

**Gjetja** Ende ekzistojnë disa obligime të papaguara që nga viti 2014. Ato nuk janë paguar për shkak të hyrjes në obligime në atë kohë pa u siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Gjatë vitit 2018 komuna ka ndërmarr masa që të konfirmoj ekzistencën e këtyre obligimeve duke kërkuar konfirmime për obligime nga furnitorët. Obligimet në vlerë prej 1,050€ për servisim të veturave gjatë vitit 2014 janë konfirmuar.

Gjithashtu janë evidentuar edhe vonesa në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve prej të cilave së paku tri fatura janë evidentuar me vonesë më shumë se 30 ditë nga data e pranimit të faturës.

**Rreziku** Hyrja në obligime pa u siguruar paraprakisht mjetet financiare si dhe mos pagesa me kohë e obligimeve mund të shkaktojë kosto shtesë dhe dëmtim të buxhetit nga ngritja e padive gjyqësore prej furnitorëve.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e obligimeve ndaj kontraktuesve. Hyrja në obligime të bëhet vetëm nëse paraprakisht janë zotuar mjetet e mjaftueshme financiare. Obligimet të paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave. Poashtu të gjinden zgjidhje për shlyerje të obligimeve të cilat datojnë nga viti 2014.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi që kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet.

Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

---

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Janë vërejtur përmirësime sa i përket qeverisjes brenda Komunës së Junikut veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigjet efektive ndaj rekomandimeve të auditimit janë bërë dhe operimi i një sistemi më cilësor të auditimit të brendshëm është vendosur. Komiteti i auditimit është themeluar në fillim të vitit 2019 dhe pritet funksionimi i tij gjatë këtij vitit, gjë që do ndikoj pozitivisht në pavarësinë e duhur të auditimit të brendshëm. OB poashtu ka përmbushur kërkesën e MF lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj. Komuna e Junikut ka hartuar planin zhvillimor komunal, planin rregullues urban, rregulloret e brendshme, planet vjetore të punës sipas drejtorive dhe raportin vjetor të punës.

### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Nga 37 rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit të brendshëm, NjAB ka vlerësuar se 15 prej tyre janë zbatuar, 10 në proces të zbatimit dhe 12 nuk ishin zbatuar për shkak të afatit të tyre të zbatimit deri në vitin 2019.

---

#### Çështja C4 - Mungesa e Komitetit të Auditimit

**Gjetja** Komuna gjatë vitit 2018 nuk e kishte të themeluar Komitetin e Auditimit. Këtë e ka bërë në vitin 2019. Në vitin 2019 është mbajtur një takim me komitetin e auditimit. Komuna duhet të sigurohet që komiteti do të mbledhet rregullisht dhe do të adresojë raportet dhe çështjet e dalura nga raportet e auditimit të brendshëm, në mënyrë që rekomandimet adresohen me kohë dhe ipet përgjegjësi për gjetjet e nxjerra.

**Rreziku** Mos funksionimi si duhet i komitetit të auditimit mund të rezultojë në rrezik që çështjet e identifikuara të mos adresohen me kohë si dhe në nivel më të ulët të përgjegjësisë nga menaxhmenti i komunes.

**Rekomandimi C4** Kryetari duhet të sigurojë që rekomandimet e auditimit të brendshëm zbatohen në tërësi si dhe komiteti i auditimit është vazhdimisht funksional.

---

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedojë raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguuar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën. Menaxhmenti organizon takime me zyrtarët udhëheqës dhe se ka vendosur një proces formal të raportimit të brendshëm nga drejtoritë komunale.

Gajtë vitit 2018 komuna ka hartuar procedura për menaxhimin e rrezikut si dhe regjistër të rrezikut me hapa adekuat duke u nisur nga objektivat konkrete për menaxhim të rreziqeve të identifikuara, veprimet konkrete që duhet të ndërmerren, departamentet përgjegjëse dhe afatet kohore të përmbushjes së objektivave. Me këto veprime Kryetari ka siguruar delegim të drejtpërdrejtë të përgjegjësive për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës të administratës. Poashtu është paraparë që departamentet përgjegjëse të raportojnë rregullisht, në baza tremujore për të arriturat në lidhje me objektivat e menaxhimit të rrezikut.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Junikut ka rezultuar me katërmbëdhjetë rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, pesë rekomandime janë zbatuar, ndërsa pesë të tjera ishin perseritur dhe kater prej tyre ishin zbatuar pjesërisht.

Gajtë vitit 2018 konsiderohet që Komuna ka shtuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve. Kjo për shkak se Kryetari ka siguruar krijimin dhe zbatimin e planit të veprimit, i cili monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta në lidhje me progresin e arritur në fushat e identifikuara. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari si dhe ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e viti 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	2.3. Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e saktë të pasurisë. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. Gjithashtu kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur të gjitha kërkesat tjera për raportim konform kërkesave rregullative.	Janë marrë masa gjatë vitit 2018, pasuritë janë regjistruar dhe vlerësuar mirëpo ende nuk janë regjistruar në SIMFK. Poashtu është punuar në drejtim të përdormit më të mirë të e-pasurisë, por mbetet plotësia e e-pasurisë të arrihet.	E pa zbatuar
2	3.2. Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se performanca e inkasimit monitorohet në mënyrë sistematike nga drejtoritë përkatëse dhe zyra e financave, dhe që ky rishikim adreson me kohë barrierat që vështirësojnë inkasimin e të hyrave sipas planit. Gjithashtu, të sigurohet se të hyrat klasifikohen drejtë dhe regjistrohen me kohë në SIMFK.		E pa zbatuar
3	3.4. Menaxhimi i personelit	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet e rekrutimit zhvillohen në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante të cilat sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.	Janë marrë masa, mirëpo ende duhet punuar në përmirësim të kësaj pike.	E pa zbatuar



4	3.5. Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit dhe vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, si dhe ato të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.	Janë marrë masa mirëpo ende ka raste kur kontrata mbi vepër bëhen pa procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit.	E pa zbatuar
5	3.6. Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se rregullorja për subvencione finalizohet dhe aprovohet brenda një periudhe të shkurtër pas pranimit të këtij raporti.	Eshte aprovuar rregullorja per subvencione ne fund te vitit.	Pjesërisht e zbatuar
6	3.7. Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kontratat publike nënshkruhen vetëm me operatorët që përmbushin në tërësi kriteret e kërkuara me dosje të tenderit.	Ka disa lëshime të identifikuar edhe gjatë vitit 2018.	Pjesërisht e zbatuar
7		Kryetari duhet të siguroj ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive bëhet në përputhje me kërkesat dhe rregulloret për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.	Janë marrë masa, mirëpo janë vërejtur përsëri dy raste gjatë vitit 2018.	Pjesërisht e zbatuar
8	3.8. Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për të gjeturat e auditimit ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive dhe nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Në këtë aspekt, të bëhen analiza të detajuara lidhur me planifikimin dhe realizimin e kontratave.		Po
9	3.9 Pasuritë kapitale dhe jo- kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se automjetet zyrtare shfrytëzohen në pajtim me rregullat dhe kërkesat ligjore. Për secilin automjet zyrtar të shfrytëzuar duhet të mbahet evidencë e plotë dhe e saktë lidhur me kilometrat e kaluara si dhe të dhëna tjera të nevojshme.	Janë marrë masa, është krijuar një bazë e të dhënave, por ende nevojitet përmirësim në këtë pike.	Po
10	3.10 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar inkasimin me kohë të llogarive të arkëtueshme.		Po

11	3.11 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e obligimeve ndaj kontraktuesve. Hyrja në obligime të bëhet vetëm nëse paraprakisht janë zotuar mjetet e mjaftueshme financiare. Obligimet të paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.		E pa zbatuar
12	4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime proaktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.		Po
13	5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e plotë të rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Planet e veprimit në zbatimin e rekomandimeve të monitorohet vazhdimisht nga menaxhmenti. Gjithashtu të shqyrtohen mundësitë e krijimit të Komitetit të Auditimit, apo në bashkëpunim me ndonjë komunë tjetër të angazhojë komitetin e auditimit me komunën bashkëpunuese.		Pjesërisht e zbatuar
14	5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës të administratës dhe të sigurojë raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		Po
Nr	Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		

1	2.3. Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e saktë të pasurisë.</p> <p>Duhet të vazhdohet në zbatimin e rekomandimeve të bëra gjatë auditimeve paraprake sipas planit të veprimit si dhe nevojitet përmirësim në përpilimin e planit vjetor të prokurimit, gjegjësisht planifiimi më i mirë i prokurimit është i nevojshëm. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.</p>
2	3.2. Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se të hyrat regjistrohen me kohë në SIMFK në mënyrë që analizat dhe raportimet të mbështeten në informata të sakta.
3	3.4. Menaxhimi i personelit	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet e rekrutimit zhvillohen në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante të cilat sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.
4	3.5. Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit dhe vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike si dhe ato të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.
5	3.6. Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se rregullorja për subvencion zbatohet duke përcjellë të gjitha procedurat përkatëse, deri te miratimi i tyre. Për më shumë Kryetari duhet të sigurohet që përcjellen procedurat edhe për monitorim dhe raportim sipas rregullores në fuqi.
6	3.7. Investimet kapitale	Personat profesional të ofruar nga operatori gjatë procesit të ofertimit duhet të jenë të angazhuar për punë për të cilën edhe janë kërkuar nga komuna. Mbikqyrësi i caktuar nga komuna duhet të sigurojë që personat e tillë janë angazhuar në realizimin e projektit. Në rastin kur operatori ekonomik duhet zëvendësuar këta persona, atëherë paraprakisht ata duhet të jenë të aprovuar nga komuna, në mënyrë që të sigurohet që operatori ekonomik ka profesionalizëm të duhur në realizimin e projektit.
7		Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë efektive në zbatimin e proceduarve të prokurimit dhe menaxhimin e kontratave si dhe të aplikoj masa për ndarje të duhur të detyrave në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore.
8		Kryetari duhet të sigurohet që komisioni i vlerësimit duhet të bëjë vlerësimin e ofertave saktësisht sipas kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit. Kryetari poashtu duhet të sigurohet që secili projekt i përfunduar ka të kryer pranimin teknik.

9	3.9 Pasuritë kapitale dhe jo- kapitale	Komuna, situacionet e realizuara duhet ti regjistroj ne SMKF si investime në vijim. Pastaj me përfundim të projektit, duhet të bëhet kërkesa në thesar që situacionet e regjistruara të hiqen dhe pastaj të kapitalizohet i tërë projekti si i përfunduar në SMKF.
10		Kryetari duhet të sigurohet që lista e gjeneruar nga e-pasuria është e plotë dhe prezenton saktësisht vlerën e pasurive nën 1,000 € të cilën komuna e ka në pronësi. Poashtu kryetari duhet të sigurohet që peroni përgjegjës për menaxhim të pasurive ka nivelin e duhur të njohurive dhe raporton saktësisht vlerën e pasurive në PFV.
11	3.12 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë kontrole shtesë në menaxhimin e obligimeve ndaj kontraktuesve. Hyrja në obligime të bëhet vetëm nëse paraprakisht janë zotuar mjetet e mjaftueshme financiare. Obligimet të paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e pranimin të faturave. Poashtu të gjinden zgjidhje për shlyerje të obligimeve të cilat datojnë nga viti 2014.
12	4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që rekomandimet e auditimit të brendshëm zbatohen në tërësi si dhe komiteti i auditimit është vazhdimisht funksional.

---

# Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

## Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrinë në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrinë në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrinë të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

## Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

---

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letër Konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: “Univerzum Audit” Sh.p.k.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Junikut, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Agron Kuçi

Kryetari i Komunës së Junikut

Data: 16.Maj 2019, Junik

